

Tirane me 24.10.2018

KONTRATE

Shitblerje Kuotash te Shoqerise "CLOVER " Sh.p.k., NUIS

Sot me date 24.10.2018(dymije e tetembedhete), une e nenshkruara Elisabeta Gjebrea, ortake e vetme e shoqerise "CLOVER" Sh.p.k., NUIS L82212021T, ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, Kodit civil si dhe legjislacionit ne fuqi, rame dakort per hartimin dhe nenshkrimin e kesaj kontrate Shitblerje Kuotash si me poshte vijon:

Znj. Elisabeta Gjebrea, lindur me dt. 20/02/1978, ne Lushnje, dhe banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. 027921514, zoteruese e 1 kuote te ndare ne 100 (njqind) pjese me vlere nominale 1.000 (nje mije) leke/pjese, dhe me vlere totale 100.000,00 (Njqind mije) leke,

referuar me poshte si Shitesi.

Dhe

Z. Massimo Piazzalunga, shtetas Italian, lindur ne Rome(Itali) me 06/05/1958 dhe banues ne Macedonia ne adresen Naroden Front 9/13 Skopje MK, mbajtes i pasaportes me nr. AA3328513,

referuar me poshte si Bleresi,

hartojme kete kontrate shitblerje kuotash me nenet e meposhtme;

Neni 1

Objekti

Objekt i kesaj kontrate eshte shitblerja e kuotes se zoteruar nga shitesi tek bleresi, kuote e cila perben 100(njqind) % te kapitalit te shoqerise "CLOVER" Sh.p.k., NUIS L82212021T, qe i korrespondon nje sasie prej 1 pjese, me vlere nominale 100.000 (njqind mije) Lek, dhe ku vlere totale e kapitalit te shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) Lek.

Ortaku i vetem i shoqerise znj. **Elisabeta Gjebrea** i shet 100 % te kapitalit te shoqerise me nje vlere prej 100.000 ,00 (njqind mije) leke, bleresit.

1/2.

Neni 2

Çmimi

Shitesi i shet Bleresit kuoten qe ka ne dorezim. Çmimi total i vleres se kontrates eshte i barabarte me 100.000 ,00 (njqind mije) lek.

Neni 3

Menyra e pageses

Palet jane likuiduar paraprakisht per vleren totale te kuotave te shitura me vlere 100.000 ,00 (njqind mije) leke dhe nuk kane pretendime lidhur me kete fakt.

Neni 4

Te drejtat dhe detyrimet e paleve

Nga nenshkrimi i kesaj kontrate Shitesi humbet te drejten e pronesise mbi kuoten ne zoterim, pronesi te cilen e fiton Bleresi i cili shnderrohet ne ortak me 1 kuote me vlere totale 100.000 ,00 (njqind mije) leke.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, pala blerese eshte pronare e vetme te kuotave te kesaj shoqerie.

Te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe burojne ne baze te legjislacionit ne fuqi nga titulli i pronesise mbi kuotat objekt shitblerjeje, qe nga nenshkrimi i kesaj kontrate i kalojne Bleresit.

Shitesi dhe bleresi bien dakort qe pas nenshkrimit te kesaj kontrate te gjitha te drejtat dhe detyrimet tregtare, tatimore, dhe te tjera te ngjashme, te cilat kane lindur mbi shoqerine CLOVER dhe ato qe do te lindin me vone, te bien mbi bleresin, ne kushtet kur ky i fundit do te jete pronari dhe ortaku i vetem i shoqerise.

Neni 5

Hyrja ne fuqi

Kjo kontrate hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj nga palet pjesemarrese.

Neni 6

Te ndryshme

Palet zotohen se do te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje lidhur me kete kontrate ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate iu lexua paleve me ze te larte. Ato pasi e kuptuan permbajtjen e saj, e nenshkruan me vullnetin e tyre te lire dhe te plote.

Kjo kontrate hartohet ne 3 kopje origjinale me fuqi te njejte juridike. Nje kopje e kesaj kontrate do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit per te bere te mundur regjistrimin e kalimit te kuotave, dhe kopjet e tjera do te mbahen perkatesisht nga nje e tille prej bleresit dhe shitesit.

Sa me siper nenshkruajme kete kontrate me mirekuptim te plote dhe me vullnet te lire.

Shitesi


Elisabeta Gjebre
CLOVER Sh.p.k.
NIFIS : L 82212021 T
Tiranë - Albania

Bleresi

Massimo Piazzalunga
